

VENDIM
Nr. 26, datë 27.5.2022

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.03.2022 si dhe nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
 - 227 lekë/litri për gazoilin;
 - 225 lekë/litri për benzinën;
 - 78 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.
2. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
 - 239 lekë/litri për gazoilin;
 - 237 lekë/litri për benzinën;
 - 90 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.
3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 27.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.
4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar.
5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi